



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës shpall:

K O N K U R S

PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATIT PËR AUDITOR TË PËRGJITHSHËM

Numri i Referencës: AP – 01 - 2021

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar.

Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës:

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollojnë:

- veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë.
- përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal.
- veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.

Kriteret që duhet të plotësohen për t'u zgjedhur kandidat për Auditor të Përgjithshëm, janë si në vijim:

Auditori i Përgjithshëm duhet të jetë një person i cili posedon kualifikimet e kërkuara, me moral të lartë, i paanshëm, i ndershëm, dhe me integritet për kryerjen e funksionit si dhe:

- duhet të posedojë diplomë universitare dhe përvojën e duhur në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, financave publike ose administratës publike për jo më pak se tetë (8) vite, nga të cilat duhet të jenë katër (4) përvojë menaxheriale;
- nuk është subjekt i një hetimi për kryerje të një vepre penale, nuk është nën procedure penale dhe nuk është dënuar nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale;
- nuk është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tre (3) vjeçare, para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politikisht ose bartës i një posti udhëheqës, ose vendimmarrës në një subjekt politik.

Mandati i Auditorit të Përgjithshëm

Auditori i Përgjithshëm emërohet për mandat pesë (5) vjeçar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas propozimit të Presidentes së Republikës së Kosovës.

Kandidati duhet t'i dorëzoj këto dokumente për aplikim:

- letër motivimi, e cila përfshinë përshkrimin e shkurtër për vizionin e zhvillimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (maksimum 500 fjalë);
- Curriculum Vitae – e cila duhet të përmbajë arritjet në punë dhe datat e sakta të punës;
- dëshmi për përgatitjen shkollore dhe profesionale (kopjet e diplomave);
- dëshmi për përvojën e punës;
- dokument identifikimi (kopja e letërnjoftimit ose e pasaportës);
- dëshmi, që nuk është subjekt i një hetimi për kryerje të veprës penale, nuk është nën procedurë penale dhe nuk është dënuar nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale. Kjo dëshmi nuk duhet të jetë më e vjetër sesa data e shpalljes së konkursit;
- deklarata nën betim, se nuk është, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tre (3) vjeçare, para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politikisht ose bartës i një posti udhëheqës, ose vendimmarrës në një subjekt politik (*forma e Deklaratës nën Betim është pjesë e Rregullores (P) Nr. 01/2018 për procesin e propozimit të emërimit të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës (29.03.2018), e cila gjendet në ueb faqen e Zyrës së Presidentes*). Përmbushja e këtij kriteri do të verifikohet nga ana e Komisionit në bashkëpunim me institucionet tjera relevante (KQZ, Thesari, etj.)

PROCEDURA E KONKURIMIT:

Dokumentacioni i kompletuar për aplikim duhet të dërgohet jo më vonë se deri më 14.05.2021, në orën 15:00.

Dokumentacioni i kompletuar për aplikim për Auditor të Përgjithshëm dërgohet personalisht në Zyrën e Presidentes apo përmes postës:

Adresa: Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, Sheshi “Nëna Terezë” pn, ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Informata të tjera plotësuese mund të merren çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrin e telefonit: në mobil +383 45 224 224.

Dokumentacioni për aplikim i pa kompletuar me të dhënat e kërkuara konsiderohet i pavlefshëm.

Ky rekrutim do të monitorohet nga përfaqësuesit e Projektit Britanik për Emërime të Larta të Lidërshtipit. Kandidatët njoftohen se emrat, rezultatet dhe kualifikimet e kandidatëve me renditjen më të lartë në këtë proces zgjedhor të kualifikuar për votim nga Kuvendi i Kosovës do të publikohen në faqen e internetit të projektit. Kur aplikoni për këtë pozicion do të konsiderohet se është dhënë pëlqimi për botim përkatës. Do të konsiderohet gjithashtu se është dhënë pëlqimi që partnerët e implementimit të kenë qasje nga distanca dhe të ruajnë përkohësisht dhe në menyre të sigurt informatat në lidhje me aplikimin dhe performancën e tyre.